

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Gjykata e Brazilit MIRATON ekstradimin e Ervin Matës, kushtet që Shqipëria duhet të plotësojë për të marrë "bolin e kokainës"
ADRESA	https://newsbomb.al/aktualitet/gjykata-e-brazilit-miraton-ekstradimin-e-ervin-mates-kushtet-qe-shqip-i401265
BURIMI	newsbomb.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 13:48:27 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 13:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fcaff02fa9474e2b656994eacbc5bc4077d64e1dc30a9b66eed92428ea192485c
TEKSTI	41efe1c4b7a1363031374799c84e6ceb1cbab83339e6622c4a3a0e88ece586a6
PAMJA	7851dbaa4b159526757b16f3cc9e3f7ee527bf67936277b53492e6b88f6efd0c

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	96ae53cd69ded4b2becae6a1031a1a2661725e8d159236a6d6489e413da0b0c9
E MËPARSHMJA	5a173aca92b5b9bac959ffb616d8bfdbf15114ad937d04c88fc70e95a10bd14d
RRËNJA MERKLE	30dbb60d3d02cfc881d14f9729132b5faa86f341ad579020b2892f9612d800a7
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/96ae53cd69ded4b2becae6a1031a1a2661725e8d159236a6d6489e413da0b0c9>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

12 numrat e parë FALAS!
Version PDF

Abonohu te Revista

Kreu Politikë Aktualitet Ekonomi Kulturë & Art Rajon Sport Bota Showbiz SocialBomb



Çështjet kryesore

Arrestohet Ergys Agasi

"Retreat"-i i qeverisë në Pogradec!

SPAK godet grupin e Eldi Dizdarit dhe Dritan Gjikës

Aktualitet

15 Shtator 2026, 15:40

Gjykata e Brazilit MIRATON ekstradimin e Ervin Matës, kushtet që Shqipëria duhet të plotësojë për të marrë "bolin e kokainës"



Shkruar nga Newsbomb



Ervin Mata

Gjykata Supreme Federale e Brazilit ka miratuar unanimsisht kërkesën e vendit tonë për ekstradimin e Ervin Matës, ky vendim mësohet të jetë marrë nga trupi i parë i gjykatës në një seancë virtuale të zhvilluar nga 14 deri më 21 gusht të këtij viti.

Në vendimin e marrë, gjykata braziliane ka përcaktuar se dokumentacioni i paraqitur nga autoritetet shqiptare plotëson kushtet ligjore për ekstradim. Kjo lidhet me procedimin penal në Shqipëri, për akuza të cilat përfshijnë trafikimin e lëndëve narkotike, bashkëpunimin dhe pjesëmarrjen në grup të strukturuar kriminal.

Por ajo nuk ka gjykuar nëse Ervin Mata, është apo jo fajtor për veprat penale që i atribuohen, duke shpjeguar në vendim se në procedurat e ekstradimit kontrolli i saj është i kufizuar dhe nuk përfshin rigjykimin e fakteve, autorësisë apo provave të çështjes penale. Sipas vendimit, bëhet vetëm një vlerësim paraprak juridik për të përcaktuar nëse plotësohen kushtet për ekstradim. Gjykata konstaton se ekziston parimi i dënueshmërisë së dyfishtë, se veprat nuk janë parashkruar dhe se nuk ekziston ndonjë pengesë ligjore për ekstradimin.

Ky ekstradim është miratuar si një procedurë hetimore, pra për t'iu nënshtruar procedimit penal në Shqipëri dhe jo ekzekutimin e një dënimi të formës së prerë.

Meqëllatë, Ervin Mata **nuk i dorëzohet automatikisht autoriteteve shqiptare**

Revista



Abonohu tani dhe lexoje >

Lajmet e fundit



Bota

Shtetet e Bashkuara të Amerikës konfirmojnë për herë të parë se kanë vendosur armë hapësirore



Politikë

Gjykata e Lartë e la në burg Erion Veliajn, reagon Edi Rama: Unë e respektoj vendimin, por Tirana është pa kokë dhe askush s'do t'ia dijë për 1 milionë banorët e kryeqytetit

Zbulu më shumë artikuj >

Vendimi përcakton se dorëzimi varet nga vendimi diskrecional i Presidentit të Brazilit. Dhe përpos kësaj Shqipëria duhet të formalizojë garancitë e parashikuara në ligjin brazilian, ku mes të tjerash fakti që Mata të mos ndiqet penalisht për një fakt tjetër të mëparshëm nga ai për të cilin është kërkuar ekstradimi, t'i llogaritet koha e qëndrimit në paraburgim në Brazil dhe të mos i nënshtrohet torturës apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues.

Po ashtu në dosjen që posedon gjykata e Brazilit, përfshihen edhe të dhëna të siguruara nga komunikimet e aplikacionit Sky ECC. Ku ndër të tjera paraqitet një paterial i viti 2020, ku përdoruesi me identifikuesin GS4TDD, i identifikuar si Ervin Mata komunikonte për transpirtin e një sasive prej 250 kilogramësh kokainë nga Brazili drejt aeroportit të Frankfurtit në Gjermani.

Në një komunikim të 29 shtatorit 2020, në dosje përmendet se Mata fliste për sekuestrimin e 240 njësive të mallit në Frankfurt. Në një tjetër bisedë, ai shprehet se "të gjitha mallrat e mia u sekuestruan në Frankfurt, në doganë", ndërsa përmendet edhe dërgimi i parave përmes personave të tjerë.

Kush është Ervin Mata?

"Boli" siç njihet ndryshe është një emër i njohur për drejtësinë shqiptare, i lidhur prej vitesh me hetime për krim të organizuar dhe trafik narkotikësh. Emri i tij u bë i njohur për publikun pas ngjarjes së rëndë të vitit 2018 në zonën e ish-Bllokut në Tiranë, ku gjatë një përplasjeje me armë mes grupeve rivale kriminale humbi jetën Fabian Gaxha.

Sipas hetimeve të SPAK, Mata dyshohet si një nga organizatorët kryesorë të një rrjeti ndërkombëtar të trafikut të kokainës, që shtrihet nga Shqipëria drejt Amerikës së Jugut dhe disa vendeve të Bashkimit Europian.

Ervin Mata u shpall në kërkim në Nëntor 2023, pas 11 urdhër-arresteve të lëshuara nga Prokuroria e Posaçme, për një grup kriminal që vepron në trafikun e kokainës dhe hashashit nga Amerika Jugut, vrasjeve dhe pastrimit të parave.

Në muajt e parë të vitit 2023, media periferike raportuan se ish-partneri i këngëtares Elvana Gjata dhe një ndër personat e përfshirë në ngjarjen që mori emrin si "Masakra e ish-Bllokut", ishte zhdukur pa gjurmë në Bolivi. Mediat aluduan se disa muaj pas zhdukjes pa gjurmë së Ervis Martinajt, edhe Ervin Mata kishte pasur të njëjtin fat në Bolivi.

Mirëpo, hetimet, akuzat dhe bisedat e transkriptuara që SPAK ka siguruar nga autoritetet evropiane kanë nxjerr nga "strofulla" biznesmenin nga Tirana. Ervin Mata ishte pjesë me grupin e djalit të Erzen Breçanit dhe kishte komunikime të vazhdueshme në rrjetin e komunikimit "SKY".

Menjëherë pasi ndaj tij u lëshua urdhër-arrest ndërkombëtar, u publikua dhe një video e fundit e Ervin Matës nga arratia. Pamjet rrëzuan pretendimet se biznesmeni nga kryeqyteti ishte zhdukur në Bolivi dhe asgjë nuk dihej në fatin e tij, sepse vetë Ervin Mata tregonte të kundërtën në kamera.

Nga ish-Blloku te krimi i organizuar:

Emri i tij u bë publik për herë të parë pas ngjarjes së rëndë në zonën e ish-Bllokut në Tiranë, më 4 tetor 2018. Gjatë një përplasjeje me armë në lokalin "Monopol", u vra Fabjol Gaxha, truproja i Ervis Martinajt, një tjetër emër i njohur në botën e krimit, i zhdukur në rrethana misterioze që prej gushtit 2022. Po atë natë mbetën të plagosur vetë Martinaj dhe Eljon Hato.

Fillimisht u raportua se konflikti kishte shpërthyer për shkak të një ngacmimi ndaj këngëtares Elvana Gjata, e cila ndodhej në shoqërinë e Matës. Por më vonë, hetimet zbuluan një tjetër prapaskenë, një përplasje për një sasi të konsiderueshme kokaine, që sipas autoriteteve ishte në pronësi të Eldi Dizdarit, drejtues i njohur i "Kartelit Bello", i cili aktualisht ndodhet në Dubai.

Atë kohë sherri nisi mes mes komandos Merviol Bilo dhe Eljon Hatos të cilët janë zënë për rreth 30 sekonda me grushta, ndërsa pak më tutje po ziheshin Ervis Martinaj dhe Ervin Mata.

Në një moment viktimë Fabjol Gaxha ka nxjerrë armën dhe ka qëlluar duke bërë që

konfirmuar me vitor Bilu t'i përgjyjet për ushita me armë duke qenëuar ministrit Gjoni Matan dhe më pas mbi personat e tjerë, ku Gaxha mbeti i vetmi i vdekur.

Pas përplasjes me armë Mervjol Bilo dhe Ervin Mata ishin të kërkuar nga drejtësia. Mata u vetëdorëzua pak ditë më pas, duke mohuar të ishte ai autori i vrasjes dhe se atë e kishin sulmuar.

Marrëdhënia me Elvana Gjatën:

Në vitin 2017, Ervin Mata ishte fejuar me këngëtares e njohur shqiptare Elvana Gjata, pas një lidhjeje disa-vjeçare. Lidhja e tyre ishte mbajtur diskrete, megjithëse këngëtarja kishte folur në mënyrë të tërthortë për të në intervista publike, duke përshkruar partnerin si "një fat të mirë" që i kishte dhuruar Zoti.

"Unë mendoj që Zoti është treguar shumë i mirë me mua, më ka sjellë një fat shumë të mirë", thoshte Elvana asokohe, deklaratë e cila u interpretua në rrjet se ishte pikërisht për Matan.

Pas përfshirjes së Matës në çështje penale dhe hetime të thelluara, edhe emri i këngëtares do të dilte në skenë më vonë, për shkak të një bisede të përgjuar në aplikacionin e enkriptuar Sky ECC.

Dosja "Metamorfoza", rrjeti i kokainës dhe urdhër-arresti nga SPAK:

Më 20 nëntor 2023, SPAK firmosi një urdhër-arrest ndaj Matës, si pjesë e një operacioni të madh antidrogë të koduar "Metamorfoza". Nga hetimet rezultoi se ai kishte trafikuar rreth 250 kg kokainë nga Brazili drejt Gjermanisë, përmes aeroportit të Frankfurtit. Në bisedat e përgjuara, Mata shprehej se një pjesë e ngarkesës ishte sekuestruar, konkretisht 240 kg dhe parashikonte që lajmi të bëhej publik ditën pasuese.

Këto të dhëna çuan në ndalimin e disa personave të tjerë, përfshirë biznesmenin Pëllumb Gjoka dhe zyrtarin e lartë të policisë, Oltion Bistri.

Lidhjet me strukturat shtetërore:

Një tjetër dimension i rëndësishëm i dosjes ishte përfshirja e disa figurave të njohura të Policisë së Shtetit. Ish-nëndrejtori i Policisë së Tiranës, Erzen Breçani, dhe ish-shefi i Krimeve në Komisariatin Nr. 6, Dedan Gjoni, u akuzuan nga SPAK si të dyshuar për pastrim parash dhe ndihmë ndaj grupit kriminal.

Përveç lidhjeve miqësore dhe bashkëpunimit, Breçani dhe Mata janë të lidhur edhe përmes krushqisë, pasi djali i Breçanit është i martuar me motrën e Matës.

Supremo Tribunal Federal

Inteiro Teor do Acórdão - Página 1 de 23

24/08/2026

PRIMEIRA TURMA

EXTRADIÇÃO 1.925 DISTRITO FEDERAL

RELATOR	: MIN. ALEXANDRE DE MORAES
REQTE.(S)	: GOVERNO DA ALBÂNIA
ADV.(A/S)	: SEM REPRESENTAÇÃO NOS AUTOS
EXTDO.(A/S)	: ERVIN MATA
ADV.(A/S)	: VICTOR NAGIB AGUIAR
ADV.(A/S)	: FABIAN CALDERARO DE JESUS FRANCO
ADV.(A/S)	: MAURI RODRIGUES DE SOUSA NETO

EMENTA: EXTRADIÇÃO INSTRUTÓRIA. GOVERNO DA ALBÂNIA. PEDIDO INSTRUÍDO COM OS DOCUMENTOS NECESSÁRIOS À SUA ANÁLISE. ATENDIMENTO AOS REQUISITOS PREVISTOS NA LEI DE MIGRAÇÃO (LEI 13.445/2017) E NA PROMESSA DE RECIPROCIDADE PARA CASOS ANÁLOGOS. EXAME DE CONTROVÉRSIAS ENVOLVENDO AUTORIA DO DELITO. IMPOSSIBILIDADE. ADOÇÃO, NO BRASIL, DO SISTEMA BELGA OU DA CONTENCIOSIDADE LIMITADA. POSSIBILIDADE DE ENTREGA DO SÚDITO ESTRANGEIRO AO ESTADO. PEDIDO DEFERIDO, OBSERVADO O DISPOSTO NOS ARTS. 95 E 96 DA LEI 13.445/2017.

I. CASO EM EXAME

1. Pedido de extradição instrutória apresentado pelo Governo da República da Albânia com fundamento no art. 5º, LII, da Constituição Federal, em desfavor do nacional albanês ERVIN MATA, a fim de submetê-lo, naquele País, a processo penal pelo suposto cometimento do crime de tráfico internacional de entorpecentes e associação para o tráfico

Sondazh

Poll

Lexo gjithashtu



🕒 E Martë 15:25

Protestat në Shqipëri, ambasadori i Kroacisë mesazh qeverisë: Dëgjoni zërin e qytetarëve



Aktualitet

Ndahet nga jeta Dine Abazi, ish-presidenti i Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë


🕒 E Martë 15:05



Aktualitet

Projektligji për rritjen e pagave të magjistratëve, Prokuroria e Përgjithshme: Nuk kemi dijeni, na e dërgoni me shkrim

🕒 E Martë 13:58



🕒 E Martë 13:54

"Do na fus në telashe", rrëfimi me VIDEO i Meritës zbulon SKANDALIN, deputetja Zegjine Çaushti e dinte për vajzën që daja i saj mori peng dhe e përdhunoi, i shkoi në shtëpi



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.